

Dhjetor 2024 | Nr. 44



# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

[www.ild.al](http://www.ild.al) | [info@ild.al](mailto:info@ild.al)



Inspektori i Lartë i  
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani  
@ILD\_Albania

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
JU URON GËZUAR VITIN E RI 2025!**



**Gëzuar Krishtlindjen  
dhe Vitin e Ri 2025!**



## ILD MIKPRITI NJË GRUP STUDENTËSH E PEDAGOGËSH NGA KOSOVA

Një grup pedagogësh dhe studentësh të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, zhvilluan një vizitë studimore katër ditore pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Delegacioni nga Kosova kryesohej nga Dekani i Fakultetit Juridik, Prof. Avni Puka, që shoqërohej nga dy prodekanët, Prof. Florent Mucaj e Prof. Ardit Gashi, Profesorët Islam Pepaj dhe Muhamet Vokri, si dhe pesë studentë të nivelit të parë dhe të dytë të studimeve, Gent Bunjaku, Vlera Gjokaj, Arton Salih, Anita Baftija dhe Vlerë Hoxha.

Vizita është pjesë e bashkëpunimit që Zyra e ILD-së ka vendosur me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, përmes marrëveshjes së

nënshkruar në tetor 2022 në kryeqytetin e Kosovës.

Në ditën e parë, delegacioni nga Kosova u mikprit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe stafi i ILD-së. Duke shprehur kënaqësinë për këtë vizitë, z. Metani tha se shkëmbime të tilla me studentë e pedagogë janë shumë të rëndësishme për të ardhmen e institucionit e t'u njohur me funksionimin e ILD-së e dinamikat e punës së vet. Ky bashkëpunim merr një vlerë të shtuar kur bëhet me kolegë e studentë nga ana tjetër e kufirit.

Dekani i Fakultetit Juridik z. Avni Puka vërejt se kjo vizitë studimore në Tiranë është kënaqësi





por edhe emocion e vjen si vijim i marrëveshjes së bashkëpunimit me ILD-në. Klinika ligjore e Fakultetit Juridik në Prishtinë e ka pjesë të praktikës së punës bashkëpunimin me institucione, për shkathësimin praktik të studentëve, tha

dekani Puka.

Pedagogët dhe studentët nga Kosova zhvilluan një vizitë në ambientet e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që u pasua me një prezan-





tim të kompetencave dhe funksioneve të ILD-së, nga inspektorja znj. Joana Asimi, shoqëruar me diskutime dhe komente nga delegacioni i Kosovës.

Në ditën e dytë të vizitës studimore pranë ILD-së studentët u njohën me procesin e shqyrtimit të ankesave, verifikimin dhe hetimin disiplinor, me raste praktike të hetimit disiplinor, një modul që u paraqit nga ndihmës inspektorët z. Julis Zebi dhe znj. Ornela Shurdhaj.

“Zhvillimi i inspektimeve tematike dhe institucionale” ishte moduli me të cilin studentët nga Kosova u njohën ditën e tretë të vizitës në ILD. Prezantimi u bë nga anëtarja e kabinetit, gjyqtarja znj. Arjeta

Lika, e cila iu përgjigj interesit të studenteve mbi këtë proces pune.

Në ditën e fundit të javës në institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, studentët e Prishtinës u njohën me modelin e ILD-së, lidhur me transparencën dhe komunikimin publik, nga këshilltarja për komunikimin, znj. Mimoza Koçiu.

Gjatë kësaj vizite studimore studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës zhvilluan vizita në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

**Vizita është pjesë e bashkëpunimit që Zyra e ILD-së ka vendosur me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, përmes marrëveshjes së nënshkruar në tetor 2022 në kryeqytetin e Kosovës.**



**NGA VIZITA STUDIMORE E STUDENTËVE NGA KOSOVA**





## ILD TAKIM PUNE ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

Në kuadër të mbylljes së vitit kalendarik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një takim pune me drejtues të organizatave të shoqërisë civile, që kanë pjesë të punës së tyre monitorimin e reformës në drejtësi, e të drejtave të njeriut, transparencën, llogaridhënien e mirëqeverisjen.

Z. Metani vërejti rëndësinë që ka një komunikim i tillë jo formal dhe i vazhdueshëm, që nxit vështrime sa kritike aq edhe mbështetëse, për punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke ndarë ide e vlerësuar vendime e procese pune, nga qasja e shoqërisë civile si aktori publik, që ndikon në përmirësimin e proceseve demokratike në vend, duke nxitur transparencën dhe

**Takimet me organizata të shoqërisë civile janë një traditë e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, materializuar me një marrëveshje bashkëpunimi, nënshkruar me 6 organizata, për të nxitur rritjen e performancës e të kapaciteteve të Zyrës së ILD-së, përmes rritjes së komunikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta.**





Ilogaridhënie nga ana e institucioneve publike. Publike e Ligjore (ISPL), znj. Ina Xhepa nga Qendra për Zhvillim dhe Integrim European (CEDI), z. Z. Afrim Krasniqi nga Instituti i Studimeve Politike Gerti Shella nga Qendra për Çështje të Informimit Publik (INFOÇIP) dhe z. Gjergji Vurmo (ISP), z. Ardian Dhima nga Instituti për Studime







nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim civile janë një traditë e punës së Inspektorit të (IDM), bashkëbiseduan me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, materializuar me një të Drejtësisë mbi aspekte të punës së ILD-së marrëveshje bashkëpunimi, nënshkruar me 6 dhe çështje të sistemit të drejtësisë, duke organizata, për të nxitur rritjen e performancës përcjellë këndvështrime, por edhe propozime e të kapaciteteve të Zyrës së ILD-së, përmes për efikasitetin e punës gjatë vitit të rritjes së komunikimit dhe zhvillimit të aktivite-ardhshëm. Takimet me organizata të shoqërisë tëve të përbashkëta.



## DHJETORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Dhjetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **98 ankesa**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit Dhjetor 2024.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p><b>64 praktika të trajtuara</b> nga të cilat:</p> <p><b>49 vendime arkivimi</b> (15 praktika të bashkuara), konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 32 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;</li> <li>• 17 vendime arkivimi pas verifikimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>8 vendime verifikimi</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>1 vendim</b> për fillim hetimi disiplinor ( 1 prokuror);</li> <li>• <b>3 kërkesa</b> për procedim disiplinor për një prokuror (2 procedime) dhe një kërkesë, për një gjyqtar</li> </ul>

## ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- \* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- \* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.
- \* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,

në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin "Si pranohen ankesat".

## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Dhjetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **10 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total për vitin 2024 ka bërë ka bërë **80 shpallje publike**.







### *Gjatë asistimit të ankuesve*

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



*Gjatë muajit Dhjetor 2024, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 22 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.*



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohet nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuar, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit Dhjetor 2024, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **8 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

**SI KEMI KOMUNIKUAR ME QYTETARËT NË 2024?**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përmbyllur një vit intensiv pune, duke qenë me afër qytetarëve me trajtimin e ankesave të tyre, por edhe dhënie informacioni të kërkuar. Në harkun kohor të një viti, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka asistuar fizikisht me paraqitjen e tyre pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë **279** qytetarë nga e gjithë Shqipëria, që kanë pasur pretendime ndaj magistratëve të ndryshëm. Ata janë asistuar dhe kanë plotësuar formularin e ankesës që është publikuar edhe në faqen e internetit të institucionit [www.ild.al](http://www.ild.al).

Përveç pritjes fizike të qytetarëve në ambientet e Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë, ka pasur edhe asistencë përmes telefonatave në numrin +355 4 2217217, për **197** qytetarë, të cilët kanë marrë informacion përgjatë vitit 2024, mbi mënyrën sesi të ankohen, sa kohë zgjat përpunimi i ankesës së tyre, ku, kur dhe si mund të paraqiten dhe se ndaj kujt mund të ankohen. Për të lehtësuar edhe më shumë procesin e ankimimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e ka thjeshtuar në vijimësi formularin e ankesës, në mënyrë që qytetarët apo institucionet ta kenë sa më të lehtë të paraqesin ankesë për shkelje të dyshuara nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.

Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore,

zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Në harkun e një viti Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përbushur edhe detyrimin ligjor për të drejtën e informimit.

Kështu, gjatë vitit 2024 kanë marrë përgjigje **138** kërkesa të tilla, të paraqitura nga qytetarë, apo subjekte të tjera.

Gjithashtu, po gjatë vitit 2024 janë regjistruar 88 vendime me shpallje, në zbatim të nenit **88** të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.

**SHIFRA 2024**

- ♦ **279** pritje të qytetarëve
- ♦ **197** telefonata nga qytetarët
- ♦ **138** kërkesa për informacion
- ♦ **88** vendime me shpallje





## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË VIZITË PUNE PRANË GJEDNJ

Strasbourg 4, 5 dhjetor 2024

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani Në kuadër të kësaj vizite, ambasada e i shoqëruar nga njësia e inspektorëve, zhvilloi Shqipërisë në Strasbourg organizoi një pritje një vizitë dy ditore pune pranë Gjykatës me ambasadorë të vendeve të Këshillit të Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) Evropës, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, në cilësinë e të ftuarit të nderit bëri një panoramë të reformës në drejtësi në

Delegacioni shqiptar zhvilloi sesione profesionale pune me gjyqtarë dhe juristë të Shqipëri, sfidave dhe rolit të ILD-së dhe iu GJEDNJ-së, mbi procesin disiplinor dhe përgjigj interesit të ambasadorëve të pranishëm mbi aspekte të punës së sistemit të drejtësisë në vendin tonë. lidhjen e tij me pavarësinë e magistratëve si dhe paraqitje e diskutime të nenit 8, 10 dhe nenit 6, pjesa civile, mbi standardet e punës në kontekstin e procedimeve disiplinore.

FOTO NGA AKTIVITETET NË STRASBURG







## METANI: KOORDINIMI INSTITUCIONAL I SHËRBEN CILËSISË SË DREJTËSISË

Tiranë, 13 dhjetor 2024

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një takim pune në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ku u prit nga anëtarë të KLP-së, këshilltarë ligjorë dhe përfaqësues të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit.

Në qendër të bashkëbisedimit ishte trajtimi i sfidave që lidhen me komunikimin institucional dhe forcimi i mëtejshëm i sinergjisë së bashkëpunimit mes dy institucioneve për një sistem drejtësie efikas e më të qëndrueshëm.

Duke shprehur kënaqësinë për këtë takim, z. Metani vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke theksuar se dialogu i vazhdueshëm mbetet instrumenti kyç për përmbushjen e misioneve të dy institucioneve.

“Institucionet e drejtësisë në tërësi, por mbi të gjitha Këshillat (KLGJ e KLP) dhe ILD, duhet të flasin në të njëjtën gjuhë. Për t’i ardhur në ndihmë njëri-tjetrit dhe gjithë sistemit në tërësi është thelbësore të tregojmë bashkëpunim dhe sinergji në adresimin e problemeve. Ndarja dhe respektimi i pushteteve është dimension i rëndësishëm për të ruajtur integritetin dhe figurën e institucioneve. Institucionet tona janë të pavarura, të pavarura edhe në vendimmarrje, por duhet të flasim të njëjtën gjuhë vlerash, të transmetojmë të njëjtën frymë vlerash, mbi të cilat u ngrit reforma në drejtësi dhe mbi të cilat, bazohet shteti i së drejtës.”, tha mes të tjerash z. Metani.

Ndarja dhe respektimi i pushteteve është dimension i rëndësishëm për të ruajtur integritetin dhe figurën e institucioneve. Institucionet tona janë të pavarura, të pavarura edhe në vendimmarrje, por duhet të flasim të njëjtën gjuhë vlerash, të transmetojmë të njëjtën frymë vlerash, mbi të cilat u ngrit reforma në drejtësi dhe mbi të cilat, bazohet shteti i së drejtës.”, tha mes të tjerash z. Metani.

Pjesë e diskutimeve ishin edhe inspektimet tematike dhe ato institucionale, normimi i disiplinës në punën e magistratëve, si dhe tra-





jtimi i rasteve, që kërkojnë ndërhyrje emergjente. Ne takim u theksua nevoja për të krijuar një standard të përbashkët për normimin e raporteve mes drejtuesve të prokurorive/gjykatave dhe magistratëve, duke tejkaluar çështjet, që ligji nuk i qartëson, me profesionalizëm dhe bashkëpunim institucional.

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e falënderuan z. Metani për angazhimin e tij, duke

vlerësuar marrëdhënien mes dy institucioneve si korrekte dhe të bazuar në respektimin e ligjit. Ata theksuan rëndësinë e vazhdimin e këtij bashkëpunimi për të ruajtur besimin e publikut dhe standarde të larta etike e profesionale.

Ky takim pune mes ILD-së dhe KLP-së shërbeu për të reflektuar angazhimin e përbashkët për një sistem drejtësie transparent dhe të drejtë.



ILD NË TWITTER



**DHJETOR 2024**

Të gjitha të drejtat e rezervuara  
© ILD

**KONTAKT ILD**

**WEB:** [ild.al](http://ild.al)  
**EMAIL:** [info@ild.al](mailto:info@ild.al)  
**ADRESA:** Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",  
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin  
prezantues të ILD*



**Më skano!**